



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT

KËSHILLI I GJYKATËS

Nr. 630 Prot

Tiranë, më 12.12.2022

V E N D I M

Nr. 39, datë 12.12.2022

“PËR EMËRIMIN PARAPRAK TË SHTETASIT EDSI MËNAJ SI NËPUNËS CIVIL
GJYQËSOR “SPECIALIST IT”

Këshilli i Gjykatës Administrative të Apelit, i përbërë nga:

Enkelejda METALIAJ (SOFTA)

Zëvendëskryetare e Gjykatës,

Blerona HASA

Anëtare Zëvendësuese,

Leonard STRATAJ

Kancelar i Gjykatës,

Asistuar nga sekretarja gjyqësore **Kristina Përnaska**, i mbledhur në Tiranë, sot në datë **12.12.2022**, pasi kreu procedurën e vlerësimit të aplikuesit për plotësimin e vendit vakant në shërbimin civil gjyqësor në këtë Gjykatë, nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil, z. Edsi Mënaj,

V Ë R E N

Se Këshilli i Lartë Gjyqësor, me Vendimin nr. 622, datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”, ka miratuar procedurën për plotësimin e vendeve vakante në shërbimin civil.

Nga ana e Gjykatës është njoftuar Këshilli i Lartë Gjyqësor se pranë këtij institucioni është një vend vakant në shërbimin civil gjyqësor, kategoria ekzekutive, Specialist IT.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, me shkresën nr. 5281/1 prot., datë 18.11.2021, ka njoftuar Gjykatën Administrative të Apelit se Këshilli i Lartë Gjyqësor nuk disponon për momentin nëpunës civil gjyqësor të regjistruar, sipas pikës 1, të nenit 4, të Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, dhe në mungesë të kësaj liste Këshillat duhet të procedojnë me procedurat e rekrutimit sipas parashikimit ligjor dhe nënligjor.

Në ligjin nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 622, datë 10.12.2020 të Këshillit të Lartë Gjyqësor parashikohet se vendet vakante në shërbimin civil gjyqësor plotësohen me rikthimin në zbatim të një vendimi gjyqësor të formës së prerë, rikthimin, për shkak të pezullimit, nëpërmjet transferimit sipas neneve 66, 67 dhe 68 të ligjit nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në rast të pamundësisë për plotësimin si më sipër, atëherë në radhë zbatohet lëvizja paralele, ngritja në detyrë dhe në fund pranimit në shërbimin civil gjyqësor.

Në këto kushte Këshilli i Gjykatës në mbledhjen e datës 26.10.2022 vendosi të procedojë për plotësimin e vendit vakant me anë të lëvizjes paralele dhe shpalli njoftimin në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Gjykatës, si dhe gjithë gjykatave të vendit me kushtet e kërkuara. Afati i aplikimit për lëvizje paralele u caktua deri më datë 09.11.2022. Rezulton se deri në këtë datë nuk u paraqit asnjë kandidaturë dhe nga ana e Kancelarit të Gjykatës, me shkresën nr. 599 prot., datë 10.11.2022, është bërë njoftimi mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në shërbimin civil gjyqësor për pozicionin Specialist IT për mungesë aplikimi, duke lënë vendin vakant të vlefshëm për konkurrim nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil gjyqësor. Po kështu, afati për dorëzimin e dokumentave për procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor ka qenë datë 16.11.2022.

Në lidhje me procedurën e pranimit në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive për pozicionin “Specialist IT” në datën 16.11.2022 pranë Sekretarisë së Gjykatës Administrative të Apelit është paraqitur kërkesa nga kandidati z. Edsi Mënaj, me dokumentacionin shoqëruar, bashkëngjitur kërkesës.

Po kështu, Këshilli, me Vendimin nr. 585 prot., datë 21.11.2022, ka caktuar Komisionin e Pranimit, sipas nenit 54 të ligjit nr. 98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 26 të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 622, datë 10.12.2020 “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin gjyqësor civil”, dhe, më konkretisht, Kancelarin e Gjykatës me cilësinë e Kryetarit të Komisionit, Kryesekretaren e Gjykatës znj. Adela Duma si dhe përfaqësuesen e Këshillit të Lartë Gjyqësor znj. Enida Muceku, me detyrë Specialist, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, caktuar me shkresën nr. 6080/1 prot., datë 23.11.2022.

Në këto kushte, kur Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar edhe Udhëzimin nr. 85, datë 11.03.2021 “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil gjyqësor nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë dhe pranimit nëpërmjet konkurrimit të hapur”, pra përpara vlerësimit, dhe për rrjedhojë Këshilli u bazua edhe mbi këtë vlerësim.

Nga ana e Kancelarit të Gjykatës u krye verifikimi paraprak i kandidatit Edsi Mënaj, i cili, me Vendimin Nr. 588 Prot., datë 21.11.2022, ka vlerësuar se kandidati plotëson kushtet për fazën e dytë, atë të vlerësimit me shkrim nga Komisioni i Pranimi duke caktuar dhe datën e testimit, datë 01.12.2022.

Në datën, 01.12.2022, ora 08:15, në mjediset e Gjykatës Administrative të Apelit është zhvilluar vlerësimi me shkrim i kandidatit nga Komisioni i Pranimi, në përfundim të të cilit ai ka marrë 56 pikë nga 60 pikë që parashikon neni 27 i Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 622, datë 10.12.2020, pra më shumë se 42 pikë që parashikon si kusht neni 30, pika 2, i këtij vendimi. Në datën 07.12.2022 është intervistuar kandidati nga Këshilli i Gjykatës i cili ka marrë 21 pikë nga intervista.

Në total rezulton se kandidati Edsi Mënaj ka marrë 84 pikë dhe ai duhet të shpallet fitues i kësaj procedure konkurrimi e, për rrjedhojë të marrë emërimin paraprak, sipas nenit 61 të ligjit nr.98/2016 “Për Organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe nenit 34 të Vendimin nr. 622, datë 10.12.2020 të KLGJ “Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor”.

Në kushtet kur kandidati Edsi Mënaj plotëson kushtet formale për pranim si dhe ka marrë 84 pikë në vlerësim, Këshilli i Gjykatës çmon se ai duhet të emërohet si Specialist IT në Gjykatën Administrative të Apelit dhe, për rrjedhojë:


V E N D O S I

1. Emërimin paraprak të z. Edsi Mënaj në shërbimin civil gjyqësor në pozicionin “Specialist IT” pranë Gjykatës Administrative të Apelit.
2. Vendimi t’i njoftohet kandidatit z. Edsi Mënaj dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në Gjykatën kompetente.

Tiranë, sot në datë 12.12.2022.

Anëtar


Kancelari
Leonard STRATAJ



Sekretare
Kristina Përnaska


Anëtare

Anëtare Zëvendësuese
Blerona NASA



Kryetare

Zëvendëskryetare
Enkelejda METALIAJ



Stamp: GJYKATA ADMINISTRATIVE E APELIT
Date: 12/12/2022